

**AKT THEMELIMI**  
**i Shoqërisë "GOLD PEARL" Sh.p.k.**

Sot, me datë 13/12/2022,

**Z. Marjon Malaj**, shtetas shqiptar, atësia Kujtim, lindur më 15.07.1982, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i dokumentit kartë identiteti me nr. 036210327 me ID I20129050J, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërите Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**GOLD PEARL**" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1**

**EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "**GOLD PEARL**" Sh.p.k.

**NENI 2**

**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Njesia Bashkiake nr.9, Rruga: Papa Kristo Negovani, Ndertesa nr.1, H2, Tiranë, Shqipëri.**

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjeter.

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

**NENI 4**

**OBJEKTI**

**Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:**

Shoqëria do te kete per objekt te aktivitetit te saj. Te ushtroje aktivitetin ne fushen e punesimit ne Republiken e Shqiperise dhe shtete te tjera, duke rekrutuar punetore te huaj nga shtete te ndryshme te botes, per zanate te ndryshme, si ne hoteleri turizmit, bar restorant, ndertim, sherbime te ndryshme ne familje, komplekse e palestra sportive, robaqepezi, si dhe cdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme qe nuk bie ndesh me legjislacionin ne fuqi, si dhe duke punesuar shtetas shqiptare ne shtete te ndryshme sipas aftesive dhe cilesive te tyre profesionale. Konsulencë e asistencë te specializuar ne fushat e cituara me lart per problemet te punesimit. Per kryerjen e veprimtarise se saj, shoqëria mund te hape njesi sherbimi brenda dhe jashte vendit duke bashkepunuar me persona fizike e juridike vendas dhe te huaj. Pervec veprimtarive te parashikuara me lart, ne veprimtarine e shoqërise do te hyje dhe cdo veprimtari qe do te konsiderohet nga Asambleja e Ortakeve si e nevojshme dhe e pershatshme per arritjen e objektit te shoqërise dhe qe nuk vjen ne kundershtim me Ligjin shqiptar.



## NENI 5

### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakut themelues në vlerën 100.000 (një qind mijë) Lekë dhe përbëhet nga 1 (nje) kuotë.

Kapitali themeltar përbëhet si më poshtë:

- **Z. Marjon Malaj**, zoteron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 100.000 (njëqind mijë) Lekë dhe 100.000 (njëqind mijë) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra me shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## NENI 6

### ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

-Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

-Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i shoqërisë është **Z. Marjon Malaj**, shtetas shqiptar, lindur më 15.07.1982, banues në Tiranë, mbajtës i dokumentit kartë identiteti me nr. 036210327 me ID I20129050J, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

## NENI 7

### LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## NENI 8

### DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Permbajtja e Akitit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë duke autorizuar Administratorin, Z. Enton Koliçi, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

### ORTAKET THEMELUES

**MARJON MALAJ**

